# STATUTI
# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## " FERHATI -B89 " SHPK

Ky akt u nenshkrua me **dt.31.08.2021** , nga une Ortaku **Aleko FERHATI I biri I Mehmet me dtl.31.10.1989 lindur ne Kajan Elbasan dhe banues ne Kajan Elbasan , madhor dhe I afte per te kryer veprime juridike I njohur me nr.pasaporte BC4002232 me nr.personal I 91031011F leshuar me dt.08.05.2019,**, bazuar ne ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregetaret e Shoqerine Tregtare " dhe ligjin nr.9723 dt.03.05.2007 "Per qendren Kombetare te Rregjistrimit " si dhe ne ligjet e tjera qe lidhen me veprimtarine tregtare ne Republiken e Shqiperise , me vullnetin tim te lire vendosa qe krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **"FERHATI -B89 " SHPK**

## KREU I
### EMERTIMI , SELIA, KOHEZGJATJA DHE AKTIVITETI

### NENI 1.

Shoqeria emertohet **" FERHATI -B89 " SHPK** **.**Ajo eshte person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me aktin e themelimit ne kete statut dhe gjithmone ne zbatim te ligjislacion it shqiptar.

### NENI 2

Shoqeria ka seline e saj ne me adrese ne **Kajan Belsh Elbasan me nr.pasurie 97/4 e lljit ndertese+truall e ndodhur ne zone kadastrale 2026 me sip.97 m2 ndertese.**

### NENI 3.

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne çdo kohe me vendim te ortakut apo dhe me te gjitha menyrat e parashikuara ne legjislacionin Shqiptar ..

### NENI 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj.

- **Ndermarrje ndertimi per vete dhe per te trete ne kryrejen e veprimtarive ndertimore , ndertime civile, indutriale, bujqesore, turistike, dhe kompletimi me instalimet elektrike , elektronike, ...etj, qe lidhen me to.**
- **Studim, projektim,ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar .**
- **Studime urbanistikete te gjitha llojeve.**
- **Projektim, ndertim, montim, zbatim e rikonstruksion te :godinave te te gjitha llojeve, rruge te çdo kategorie, autostrada , mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, punime nentokesore ura e vepra, arti, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime, barrier dhe mbrojtje lumore diga, diga, damba, tunele,.**

- **Ndertime n/stacione elektrike, linja te tensionit te larte, te ulet e te mesem dhe shperndarjen e energjise.**
- **Ndertime impiante idrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirembajtjen e tyre.**
- **Impjante ngritese transportuese.**
- **Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike e druri.**
- **Impjante teknologjike termike e kondicionimi..**
- **Impjante e linja telefonie dhe telekomunikacioni.**
- **Impjante te brendeshme elektrike telefonike , radiotelefoni…etj.**
- **Impjante te sinjalistikes rrugore te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndriçuese .**
- **Investime ne ndertime civile, pallate e ne ndertime turistike.**
- **Hapjen e agjensive imobilare .**
- **Transport mallrash e udhetaresh .**
- **Hapjen e agjensive turistike e udhetaresh.**
- **Pika serisi per automjete .**
- **Tregti me pakice e vajrave lubrifikante , tregtim me pakice te karburanteve shitje blerje automjetesh, e paisjeve te makinerive er vete dhe per te trete. .**
- **Eksport –import e tregtim me shumice e pakice per vete dhe per te trete te te gjitha llojeve te mallrave industriale, ushqimore ndertimore, e bujqesore, te pjeseve te kembimit.**
- **Ne fushen e transportit te mallrave industriale per vete e te trete te mallrave industrial, ndertimore , ushqimore e bujqesore, ekeltroshtepiake te te gjitha llojeve, paisjeve veglave, instrumenteve te makinerive, te mejteve transportuese , ngritese, transportuese te te gjitha llojeve , kapaciteteve, tonaxheve te ndryshme, tipeve , markave dhe pjeseve te kembimit per to, gomave etj..**
- **Projektim zbatim, prodhim dhe tregitm te materialeve inerte.**
- **Ndertim hidrocentrale , prodhim te energjise elektrike dhe shitje te energjise elektrike.**
- **SH.R.S.F. per ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private per mbrojtjen e jetes se personave (kategoria A) .**
- **Sistemim dhe menaxhim I parkimeve te hapura dhe te mbyllura ne qytet.**

## E DREJTA

**Shoqeria " FERHATI-B89 " SHPK** eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, bazuar ne ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregetaret e Shoqerine Tregtare " dhe ligjin nr.9723 dt.03.05.2007 "Per qendren Kombetare te Rregjistrimit " si dhe ne ligjet e tjera qe lidhen me veprimtarine tregtare ne Republiken e Shqiperise , si dhe ne perputhje me aktin e themelimit dhe me statusin.

Shoqeria fiton personalitetin juridik qe nga momenti i rregjistrimit te saj .

## KREU II
## KAPITALI THEMELOR

### NENI 6

Kapitali fillestar I shoqerise eshte 100.000 leke (njeqind mije leke ), e ndare ne 1 kuota me vlere 100.000 leke , dhe perfaqesohet nga kontribute ne para. Ky kapital i perket kontributeve te ortakut te vetem te shoqerise **Aleko FERHATI**

### Neni 7
### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet dhe zvogelohet ne perputhje me ligjin ne fuqi.

### Neni 8
### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e ortakut te vetem te shoqerise konform ligjit ne fuqi.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III
## *ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE*

### Neni 9
### Organi Vendimmarres

-Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem.
-Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.Ajo miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
-Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem behet brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar. Ajo miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët.

### Neni 10
### Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit ( si tranferimi i kapitalit, zmadhimi i kapitalit shoqeror, financimet etj, ) duhet detyrimisht te vendosen me vendimin e ortakut te vetem. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Neni 11
## Administrimi

-Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise.
-Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të ortakut te vetem.
-Ortaku i vetem vendos per sistemin e administraimit dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin dhe kompetencat e tyre.
-Administratori/administratoret, mund te jene ose jo ortake te shoqerise.
-Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe.
-Administrator i shoqerise eshte:
**Aleko FERHATI I biri I Mehmet me dtl.31.10.1989 lindur ne Kajan Elbasan dhe banues ne Kajan Elbasan , madhor dhe I afte per te kryer veprime juridike I njohur me nr.pasaporte BC4002232 me nr.personal I91031011F leshuar me dt.08.05.2019** -Administratori i shoqerise emerohet ne kete detyre dhe ka kompetenca per nje periudhe 5 vjecare.

## Neni 12
## Kompetencat

-Administratori eshte i pajisur me kompetencat me te gjera per manaxhimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, me perjashtim te atyre operazioneve kur ne ligj ose nepermjet ketij statuti i eshte rezervuar vendimeve te ortakut te vetem.
-Administratori përfaqësone Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.
-Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut.
-Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
-Administratori ka gjithashtu të drejte të nënshkruaje kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruaje aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruaje e hartoje çdo dokument e të kryeje në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave te ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe te kryeje veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.
Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i aministratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

## Neni 13
## Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrejë padi penale kundër administratorit.
Paditësi ka të drejtë të ndjeki në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.
Ortaku që nuk eshte administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

**Neni 14**
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni15**
**Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratoret.
Mbledhja e Asamblese se Ortakut te vetem vendos rreth shperndarjes se divedenteve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 16**
**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakut te vetem.
Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**Neni 17**

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakut, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante, krijimin e Rezervës Ligjore. Rezerva e Ligjore krijohet vit pas viti nëpërmjet lënies

mënjane të një shume të barabarte me 5% të fitimit neto të realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabarte me 10% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

**Neni 18**

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi ortakut te vetem të shoqerise.

**Neni 19**
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :
Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.
Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper "

**Neni 20**
**Bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.
Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
Ortaku i shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.
Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.
Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes

**Neni 21**

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Neni 22**

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

**Neni 23**
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 24**
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 25**
**Dispozita perfundimtare**

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemlare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare **"FERHATI -B 89" SHPK** dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga une Noteri.
Elbasan me dt.31.08.2021

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**
**" FERHATI-B89" SHPK**
**Aleko FERHATI**

ALEKO FERHATI